



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE  
DHE KRIZAVE

Nr. 446/1 Prot.

Elbasan, më 19.4.2023

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj

**KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD**

Adresa: Sheshi "Gjorg Golemi", Librazhd

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", në lidhje me ligjshmërinë e Vendimit tuaj **Nr.27 datë 31.03.2023** "Për miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme në banesat e tyre nga fatkeqësi natyrore". Para se të shprehemi mbi ligjshmërinë e aktit tuaj kërkojmë të na dërgoni dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor të parashikuar në **V.K.M Nr. 329 datë 16.05.2012** "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

Nga shqyrtimi i dosjes mungojnë dokumentet e mëposhtme;

- Studimi Gjeologjik
- Leja e Ndërtimit

Deri në dërgimin e dokumentacionit, akti i juaj mbetet i pakonfirmuar.

**PREFEKTI**  
Majlinda **PERRIU**



VENDIM

Dt.03.04.2023

Nr. 41134 prot  
18

Nr.27 dt.31.03.2023

PER MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO LIGJOR DHE PER AKORDIMIN E  
NDIHMES FINANCIARE PER FAMILJET QE KANE PESUAR DEME NE BANESAT E  
TYRE NGA FATKEQESI NATYRORE

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ „ Ligjit Nr.45/2019 date 18.07.2019“Për Mbrojtjen Civile “, VKM-SE Nr.329 date 16.05.2012“Për kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes financiare,per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerzore“ ,Kreu 111/3/e si dhe VKM-se Nr.414 date 08.07.2021 “Per miratimin e procedurave dhe kriteret e ndarjes dhe te perdorimit te fondit te kushtezuar ,te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile.” Pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori I Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar .”Per dhënie te ndihmës financiare ,per demet e shkaketuara nga fatkeqesi natyrore (rreshqitje siperfaqesore toke) ne banesen e Z.Vullnet SHEHU banorë I fshatit Kostenje,NJ./A.Lunik Bashkia Librazhd.Këshilli Bashkiak I mbledhur sot me date 31.03.2023 dhe me propozim te Kryetarit te Bashkise Librazhd:

VENDOSI:

- 1.Të miratoj kërkesën e Bashkisë Librazhd,per mbeshtetje financiare per shtetasen Vullnet SHEHU banorë I fshatit Kostenje,NJ./A Lunik,për shkak se banesa e tij është dëmtuar nga fatkeqësi natyrore(rreshqitje siperfaqesore toke)
- 2.Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të përgatitur nga specialistet e Bashkise Librazhd dhe vleren financiare të demit në shumën: 181 639 lekë si dhe ndihmën emergjente në vlerën financiare 114 819 leke e llogaritur ne 50% te vlerës së demit për banesën e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore ( rreshqitje siperfaqesore toke) të shtetases Vullnet SHEHU.
- 3.Ndihma financiare per familjen e Z.Vullnet SHEHU banesa e te cilit eshte demtuar nga fatkeqesi natyrore percaktohet sipas kriterëve te VKM-se Nr.329 date 16.05.2012 .
- 4.Ndihma financiare qe do te akordohet do te perdoret per ti ardhur ne ndihme familjes se Z.Vullnet SHEHU banesa e te cilit është dëmtuar nga fatkeqësi natyrore (rreshqitje siperfaqesor toke)
- 6.Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

Sek.i Keshillit  
Elson Malluta



KRYETARI I KËSHILLIT  
Shrefki Bahiti